

që kam parë në për duart nga shkaku i plagëve të shkakëtuara nga pushkët, ashtu edhe nga të munguarit e nonjë giishu.

Kam vënë re mjaft të liosur, të verdhë nga ethet edhe me shpretkë të madhe. Nuk kish vënt ku të mos na kërkonin bar zemre, bar ethesh, bar koke, etj. Shërbimi ynë nuk do kish masë në qoftë se kishim barëra për t' u dhënë atyreve që ishin në nevojë. Pandenin se mos ishim mjekës edhe na pyetnin mi smundjen që kishte rënë nonjë malësori të ngratë, pa na kërkonin dhe bar.

Të rojuarit keq nga shkaku i vobekësisë, mungesa e mjekësve dhe të barevet, dhe mos-dienia e parimeve elementare të shëndetësisë, shkakëtojnë të humburit e një numuri të math njerëzish, të cilët munt të ishin të dobishmë më një kohë të pritme.

Eshtë nevojë e madhe që të kriohen dy ose tri Posta Infirmerie, ku të jetë e mundur që populli i mjerë të mjekohet edhe kështu të mos llihet në duart e magjistarkave të cilat e përcjellin në botën tjetër një or' e më parë.

Këtë punë sot e bëjnë nonjë prift shpirtmirë, po nuk mjafton. Duhet njerës të kësaj dege edhe me equipazhin përkatës.

Po dëgjonja së vdekja e kalamanjve është e madhe. Dhe s' është çudi kjo gjë kur nënat